



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

VLERËSIMI TREVJEÇAR I KONKURENCËS NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	
2	Aspektet teknike e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë.....	3
3	Rregullimi i Sektorit të Energjisë Elektrike – Rëndësia e Konkurrencës ne tregun e energjisë elektrike ne Kosovë	4
4	Indikatorët e konkurrencës në Tregun e energjisë ne Kosovë	5
5	Aspektet sociale qe pengojnë promovimin e Konkurrencës	6
6	Operimi Aktual i Tregut Të Energjisë Elektrike në Kosovë	7
6.1	<i>Qasja e palës së tretë në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë.....</i>	8
6.2	<i>Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë.....</i>	8
6.3	<i>Konkurrenca nga këndvështrimi i Furnizuesit</i>	9
7	Kriteret e Vlerësimit Të Konkurrencës	9
8	Përfundimet ne vlerësimin tre vjeçar te Konkurrencës	11

1 HYRJE

Traktati i Athinës kërkon krijimin e një tregu konkurrent për energji elektrike, ku të gjithë konsumatorët duhet të gëzojnë furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike dhe mundësinë për të zgjedhur furnizuesin e tyre.

Për të mundësuar zhvillimin e aktivitetit në sektorin e energjisë dhe bazuar në kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), në Kosovë janë nxjerrë ligjet primare për sektorin e energjisë si: Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike si dhe Ligji për Rregullatorin Energjisë. Me miratimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nga Kuvendi i Kosovës, është mundësuar themelimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me mandat rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë në Kosovë.

Institucion mjaft i rëndësishëm për promovimin e konkurrencës në Kosovë është Komisioni Kosovar i Konkurrencës i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, i cili bazohet në Ligjin për Konkurrencën. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është organ i pavarur dhe ka përgjegjësinë dhe autoritetin për promovimin e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve, dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë.

Zyra e Rregullatorit për Energji në konsultim me Komisionin Kosovar të Konkurrencës dhe autoritetin përgjegjës për monitorimin e ndihmës shtetërore së paku çdo tri (3) vite do të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe të vendosë dhe imponojë të gjitha masat e nevojshme dhe proporcionale me qëllim të nxitjes së konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut. Këto masa mund të përfshijnë programet për lëshimin e energjisë elektrike sipas të cilave ndërmarrjet e energjisë elektrike obligohen që të shesin ose të vendosin në dispozicion një sasi të caktuar të energjisë elektrike ose që t'i japin qasje furnizuesve të interesuar në një pjesë të kapacitetit të tyre prodhues për një periudhë të caktuar kohore.

Duhet të theksohet se vlerësimi për çdo tri vite nuk lidhet me hetimin e abuzimeve të mundshme të pozitës dominuese sipas ligjit të konkurrencës. Është vlerësim për të paraqitur masat që duhet të merren për të promovuar konkurrencë efektive dhe, në veçanti, nëse ekziston nevoja që të kërkohet të lejohen kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike për furnizues të tjerë për të mundësuar atyre për të konkurruar në mënyrë efektive.

Ky raport paraqet vlerësimin e ZRRE-së nëse ekziston apo jo konkurrencë efektive në furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar. Ky është vlerësimi i dytë i ZRRE-së për konkurrencën efektive në tregun e energjisë elektrike, ndërsa vlerësimi i parë është bërë para tri viteve.

2 Aspektet teknike të tregut të energjisë elektrike në Kosovë

Gjenerimi, transmisioni dhe shpërndarja janë komponentët themelore të sistemeve elektro-energetike të cilat janë pjesë përbërëse të një tregu të energjisë.

Linjiti paraqet rezervën kryesore si burim primar i energjisë në Republikën e Kosovës me pjesëmarrje prej rreth 97% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Miniera Sibovci Jugperëndimor, Bardhi dhe Mirashi, furnizojnë me linjit termocentralet Kosova A dhe Kosova B.

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike përbëhen nga dy termocentralet, TC Kosova A dhe TC Kosova B, dhe HC Ujmani me HC-të distributive që përbëjnë rreth 3% të kapacitetit të përgjithshëm.

Sistemi i Transmisionit ka rol të rëndësishëm në sigurinë e furnizimit dhe mbarëvajtjen e tërë sistemit elektroenergjetik. Rrjeti i Transmisionit të Kosovës paraqet nje të rëndësishme dhe ndërlidhet me sistemin elektroenergjetik të rajonit dhe Evropës. Rrjeti i Transmisionit është stabil, dhe i qëndrueshëm. Me vendet fqinjë ekzistojnë lidhje interkonektive 400 kV përveç me Shqipërinë me të cilën ekziston vetëm linja 220 kV. Kohët e fundit ka filluar ndërtimi i linjës interkonektive 400 kV - NS Kosovë B – NS Kashar (Tiranë). Humbjet në Rrjetin e Transmisionit janë zvogëluar dukshëm gjatë viteve të fundit falë investimeve të bëra, matjeve më të sakta dhe menaxhimit më të mirë.

Rrjeti i Shpërndarjes gjatë viteve ka shënuar përmirësim në furnizimin e konsumatorëve dhe në kualitetin e shërbimit. Mirëpo, me gjithë investimet e bëra edhe më tutje Rrjeti i Shpërndarjes nuk është në gjendje të sigurojë furnizim të sigurt dhe cilësi të kënaqshme për konsumatorët. Për t'u arritur nivel i pranueshëm i kualitetit të furnizimit dhe shërbimit nevojiten investime shtesë si në nivel të tensionit të mesëm, po ashtu edhe në nivelin e tensionit të ultë.

3 Rregullimi i Sektorit të Energjisë Elektrike – Rëndësia e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë

Koncepti i heqjes së të drejtave ekskluzive të ndërmarrjeve publike monopolizuese të integruara vertikalisht, dhe futja e konkurrencës në sektorin e energjisë, ka filluar të pushtojë mendjet e krijuesve të politikave të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara, që prej vitit 1980. Për shumë vjet, sektori i energjisë elektrike në shumicën e vendeve të industrializuara, është karakterizuar me zgjerimin e elektrifikimit me kërkesë të rritur, gjë që ka justifikuar një strukturë monopolizuese, ku çmimet mesatare të rregulluara janë mbajtur mbi kostot anësore, dhe bazuar në ekonomitë e shkallëzimit dhe mundësisë, arriti uljen e vazhdueshme të çmimeve. Një gjendje e tillë e lumtur e tregtisë, zgjati deri në vitet 1970 dhe 1980, kur ndikimet direkte dhe indirekte të krizave të naftës, destabilizuan të gjithë strukturën.

Është bërë e qartë që me qëllim që të arrihet efikasitet më i lartë dhe përmirësim i cilësive të shërbimeve, ka qenë e nevojshme që të paraqitet konkurrenca në sektorin elektroenergjetik. Ky koncept është përshpejtuar gjatë viteve 90', për shkak të faktit se konkurrenca ishte baza për krijimin e një Tregut të vetëm Evropian. Konkurrenca i inkurajon ndërmarrjet që të vlerësojnë me më efikasitet çdo shërbim të prodhuar.

Paraqitja e suksesshme e konkurrencës do të çojë në një industri më efikase. Prodhuesit do të përdorin më mirë centralet e tyre me qëllim që të ruajnë ose zgjerojnë numrin e klientëve që mund të mbulojnë. Rregullimi efektiv i shërbimeve të rrjeteve të ndara (p.sh Transmisioni dhe distribucioni), gjithashtu do të inkurajojë edhe uljen e çmimeve. Furnizuesit do të ndërveprojnë me më efikasitet me klientët dhe do të ofrojnë shkallë më të gjerë të shërbimeve dhe marrëveshjeve kontraktuese. Për këtë arsye, për një afat të gjatë, një shkallë e mjaftueshme e konkurrencës, do të bëjë që çmimet të jenë mesatarisht më të ulëta se sa do të ishin në një treg të rregulluar.

Karakteristikat unike të sektorit të energjisë, kryesisht domosdoshmëria e vazhdimësisë së sigurisë së furnizimit, mbrojtja e mjedisit, koncepti i përbashkët i "transpotuesit" të rrjeteve të energjisë dhe detyrimet e shërbimeve publike, kanë kërkuar vendosjen e një kornize specifike rregullative në të cilën mund të veprojnë konkurrenca dhe ndërmarrjet private. Kjo kornizë është finalizuar nga Direktivat dhe rregulloret e Komisionit Evropian për Energji Elektrike dhe Gaz (të cilat janë në fuqi tani).

Pas shumë vjet përvojë me hapjen e sektorit të energjisë ndaj konkurrencës, shumë vende tani kanë prezantuar një kornizë pak a shumë të ngjashme rregullative për një treg të liberalizuar energjie, që përbëhet nga:

- Një autoritet i pavarur Rregullativ me një mandat minimal monitorimi dhe promovimi të zhvillimit dhe veprimit të tregut, aprovimin e çmimeve për aktivitetet jashtë tregut, lëshimin e urdhëresave, rregullave dhe masave për qasjen jo diskriminuese të palëve të treta në rrjetet e energjisë;
- Një operator i pavarur i Sistemit të Transmisionit
- Tregjet Konkurruese në Prodhimin me shumicë dhe në Furnizim;

Direktivat e BE-së kërkojnë monitorim nga afër të tregut dhe mundësinë për të paraqitur një numër të detyrimeve kryesore në kompanitë e energjisë (“detyrimet e shërbimeve publike”), në lidhje me shërbimet publike. Këto detyrime mund të përfshijnë “shërbime universale” (e drejta e të gjithë konsumatorëve për t’u lidhur dhe furnizuar) mbrojtja e konsumatorëve në nevojë, mbrojtja e konsumatorëve të fundit (transparenca e kushteve kontraktuese dhe qasje e garantuar për të kundërshtuar marrëveshjet), etj. Këto përkujdesje janë veçanërisht të rëndësishme gjatë periudhës së tranzicionit nga një monopol plotësisht i rregulluar, në një situatë ku tregu vendos tiparet e rëndësishme, siç janë çmimi dhe vendimet për investime. Roli i Autoritetit Rregullativ të pavarur është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e detyrimeve të shërbimeve publike, të vendosura prej Qeverisë në politikën e tregut dhe në aprovimin e nivelit të duhur të kompensimit për zbatimin e saj.

Duhet të theksohet se në vendet ku nuk ka konkurrencë të mjaftueshme në anën e gjenerimit dhe të furnizimit, shpesh aplikohet rregullimi në të gjitha elementet e tregut (gjenerim, transmision, shpërndarje dhe furnizim), siç është rasti i Kosovës por edhe në vende të tjera. Ndarja fillon me pjesën e transmisionit, pastaj vazhdon me shthurjen e sistemit të shpërndarjes, duke përkrahur hapjen e tregut të energjisë për të gjithë konsumatorët.

4 Indikatorët e konkurrencës në tregun e energjisë në Kosovë

Tregjet e energjisë elektrike në përgjithësi janë të ndjeshme, dhe është e rëndësishme që të merren masat që struktura e tregut të jetë e tillë që të mundësohet konkurrenca. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur indikatorët e konkurrencës, ku përmes tyre mund të kuptohet shkalla e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

Indikatorët Kryesor të Përformances - Struktura e tregut		
Indikator	Masa/Shkalla	Komenti
Lidha reciproke e çmimeve në mes zonave të çmimeve	lidhja reciproke në mes çmimeve të tregut me shumicë	Mbështetet në disponueshmërin e çmimeve
Dallimet e çmimeve	Çmimit në mes zonave të tregut	Mbështetet në disponueshmërin e çmimeve
Koncentrimi i tregut, Gjenerimi	HHI* C3** Numri I kompanive që ka më shumë se 5% të tregut	MW, GWh
Koncentrimi i tregut, Tregu me pakic	HHI* C3** Numri I kompanive që kanë më shumë se 5% të tregut	GWh
Sthurja vertikale e gjenerimit nga TSO	Funksionale dhe Llogarit: PO= 100%, JO=0% Ligjore: PO= 100%, JO=0% Pronësi: PO= 100%, JO=0%	Matja duhet të bazohet në kërkesat ligjore që zbatohen
Sthurja vertikale e furnizimit/tregut me pakic nga DSO	Funksionale dhe Llogarit: PO= 100%, JO=0% Ligjore: PO= 100%, JO=0% Pronësi: PO= 100%, JO=0%	Matja duhet të bazohet në kërkesat ligjore që zbatohen

*Herfindahl-Hirshman Indeksi

** Koncentrimi i tri kompanive më të mëdha

Nga indikatorët lart vërehet se kërkohet dallimi i çmimeve (çmime të ndryshme), ndërsa në Kosovë kemi çmime të rregulluara, gjë që dëshmon se nuk ekziston dallimi i çmimeve. Për më tepër shkalla e konkurrencës në Kosovë është e ulët, ku një gjenerator i vetëm shtetëror (TC Kosova A, B) dominon afër 90%¹ të tregut të brendshëm dhe ekziston detyrim ligjor që këta gjenerator së pari të furnizojnë konsumatorët vendas tarifor. Kjo kufizon mundësitë për konkurrencë dhe redukton ose eliminon nxitje për konsumatorët e kualifikuar për të ushtruar eligjibilitetin².

Që të mos ketë kufizime për përfshirjen e furnizuesve të ri në treg është bërë edhe sthurja e furnizimit dhe distribucionit. Kjo shturje është shumë më rëndësi për promovimin e konkurrencës në mënyrë që të eliminohet mundësia e trajtimit jo të barabartë të furnizuesve të ri.

5 Aspektet sociale që pengojnë promovimin e Konkurrencës

Kosova vuan nga mungesa e energjisë elektrike. Edhe pse tarifatat e rregulluara mund të mbulojnë koston e sistemit ekzistues, niveli i çmimeve ekzistuese është i pamjaftueshme për të mbuluar koston e investimeve të reja në baza komerciale. Rritja e çmimeve në këtë mënyrë mund të konsiderohet se përbën një pengesë të madhe në përballueshmërinë e çmimeve nga konsumatorët.

Me çmimin aktual të rregulluar, interesi i konsumatorëve të kualifikuar për të ushtruar të drejtën e tyre që të zgjedhin furnizuesin, është mjaft i kufizuar.

Në disa vende jashtë Kosovës, konsumatorët e kualifikuar janë të detyruar të dalin në tregun e hapur (p.sh. Kroacia). Në mënyrë që të krijohet hapje e tregut, është e nevojshme të rritet gradualisht

¹ 10% i mbetur mbulohet përmes importit

² E drejta për të zgjedhur furnizuesin

numri i konsumatorëve në tregun e hapur. Kjo mund të bëhet duke eliminuar tarifat e rregulluara për konsumatorët e kualifikuar, duke i ndryshuar rregullat e tarifave.

6 Operimi aktual i tregut të energjisë elektrike në Kosovë

Procesi i Athinës ka nxitur reforma dhe zhvillime të reja në të gjitha nivelet e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë, duke filluar nga aspekti institucional, juridik dhe rregullativ, e deri te niveli operativ. Qëllimi është i qartë, vendosja e një modeli tregtues transparent dhe likuid, që vepron mbi parimin e konkurrencës së lirë dhe jep sinjale si për ofruesit e shërbimeve ashtu edhe për shfrytëzuesit.

Elementet thelbësore që marren parasysh nga rregullatori bazuar në kërkesat e TKE, dhe që sigurojnë një treg konkurrues dhe likuid, janë:

- oferta dhe kërkesa (furnizimi që tejkalon kërkesën);
- qasjen jo-diskriminuese të Palës së Tretë (TPA) në rrjet dhe kosto-reflektive;
- sinjalet e mirëfillta (reagimin e gjenerimit dhe konsumit ndaj sinjaleve të çmimeve që nënkupton njësimin dhe matjen moderne si dhe infrastrukturën moderne të telekomunikimit);
- numër i mjaftueshëm i blerësve dhe shitësve me koncentrim jo të madh;
- trajtimi i mirëfilltë i subvencioneve;

Komponentët e paraqitura më lart nuk e kanë arritur maturitetin e duhur që të garantojnë likuiditet dhe konkurrencë të mjaftueshme, si pasojë e mungesës së kushteve teknike. Deri tani tërë energjia shit-blihet përmes kontratave bilaterale në mes të KESCO-Furnizuesit Publik, në njërin anë me prodhuesit në Kosovë dhe tregtarët, në anën tjetër. Kontratat shit-blerëse në nivelin me shumicë në mes të KESCO-Furnizuesit Publik dhe KEK-Prodhuesve Publik (Kosova A dhe B) janë të rregulluara, si dhe në nivelin me pakicë KEDS si Furnizues Publik furnizon të gjithë konsumatorët tariforë me tarifa të rregulluara.

Kosova ka mungesë të energjisë elektrike dhe për tejkalimin e kësaj mungese, nevojitet importi i energjisë në njërin anë dhe/apo reduktimet e detyrueshme të energjisë të organizuara dhe të paracaktuara sipas skemave përkatëse. Në një të ardhme të afërt importi i energjisë elektrike parashihet të jetë relativisht i shtrenjtë për shkak të mungesës së energjisë elektrike në rajon, çka komplikon procesin e vendosjes së një tregu nacional të organizuar konkurrues dhe likuid.

Reformimi i sektorit të energjisë në Kosovë daton që nga viti 2004 si rezultat i themelimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Procesi i reformimit më tej ka vazhduar me shthurjen e kompanisë vertikalisht të integruar KEK, nga ku është krijuar KOSTT-i (viti 2006) që tani operon si entitet i veçantë i transmisionit dhe tregut. Shthurja e mëtutjeshme ka vazhduar me shpërndarjen dhe furnizimin e KEK-ut, dhe pastaj privatizimin e tyre me kalim në pronësi të konsorciumit Limak-Çalik. Kështu nga data 08 maj 2013, Qeveria e Kosovës ka finalizuar projektin për privatizimin e shpërndarjes dhe furnizimit publik e cila menaxhohet nga konsorciumi Limak-Çalik, ndërsa pjesa tjetër e KEK-ut është në pronësi publike dhe përfshinë mihjet dhe gjenerimin.

ZRRE me Udhëzuesin për shthurje të KEDS (OSSH dhe FEE) në Prill 2014 ka obliguar KEDS që të ndaj në mënyrë ligjore OSSH-në nga Furnizuesi publik. Këto dy kompani tash e tutje veprojnë si dy entitete ligjërisht të pambaruara.

Pamjaftueshmëria e kapaciteteve gjeneruese ekzistuese për të plotësuar nevojat e furnizimit dhe nevoja për investime në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, kërkon iniciimin e një ristrukturimi të sektorit të energjisë përmes liberalizimit të tregut dhe rritjes së konkurrencës në tregun e

energjisë elektrike. Me qëllim të arritjes së këtyre objektivave KOSTT-i gjatë vitit 2012 ka përgatitur dokumentin Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike, që në Mars të vitit 2013 është aprovuar nga Bordi i ZRRE-së. Bazuar në Dizajnin e Tregut janë zhvilluar Rregullat e Tregut të cilat në fund të vitit 2013 janë aprovuar.

6.1 Qasja e palës së tretë në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë

Një ndër elementet kryesore në krijimin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike është koncepti i Qasjes së Palës së Tretë (Third Party Access - TPA). Aspekti parimor i këtij koncepti rrjedh nga parimet rregullative të tregut të energjisë dhe obligimet ligjore të operatorëve për të ofruar qasje transparente dhe jo-diskriminuese të palës së tretë në rrjetin (sistemin) transmetues apo të distribucionit. Kjo nënkupton se çdo pjesëmarrës i tregut ka të drejtë që, mbi bazën e parimeve të parashtruara, të shfrytëzoj sistemin, i cili i mundëson realizimin e transaksioneve shitblerëse të energjisë elektrike.

Nga aspekti i tregut nacional me shumicë, qasja nga të gjitha aspektet është e rëndësishme. Parimet e shfrytëzimit të sistemit të KOSTT-it për tregti brenda kufijve të Kosovës, janë të definuar mirë dhe janë të aplikueshme, prandaj kjo paraqet përparësi në zhvillimin e tregut nacional dhe rrjedhimisht ndihmon në promovimin e konkurrencës edhe hapjen e tregut me shumicë. Edhe teknikisht, pas instalimit të njehsorëve në kufijtë komercial me palët, tashmë janë krijuar kushte për të akomoduar pjesëmarrës të ri në tregun me shumicë.

Në aspektin e tregtisë ndërkuftare, ekzistojnë pengesa dhe obstrukcione të vazhdueshme. KOSTT nuk trajtohet si palë e barabartë me TSO tjera rajonale: nuk bënë alokimin e kapaciteteve ndërkuftare dhe nuk është pjesë e ITC mekanizmit. Kjo njëherit është edhe pengesë për palët e reja që janë të interesuar për tregun e Kosovës dhe paraqet vështirësi për palët ekzistuese në realizimin e tregtisë ndërkuftare që lidhet me Kosovën. Duke qenë një treg me numër të limituar të palëve dhe rrjedhimisht likuiditet të ulët, kjo pengesë konsiderohet më kryesore në hezitimin e palëve të reja për t'iu qasur tregut të Kosovës.

Sa i përket qasjes së palës së tretë, relevancën e saj me sistemin transmetues dhe funksionet e Operatorit të Tregut, mund të konkludojmë se KOSTT ka përgatitur një kornizë të mirë ligjore dhe teknike që kjo të realizohet me sukses. Natyrisht kjo qasje i referohet tregut me shumicë, kurse realizimi i hapjes së tregut me pakicë i referohet plotësisht të kriterëve në sistemin e distribucionit.

Deri më tani Distribicioni nuk ka pasur një metodologji për shfrytëzimin e sistemit të distribucionit, por modeli tarifor i dizajnuar e parasheh ndarje të kostove për shfrytëzimin e sistemit, por kjo nuk mund të konsiderohet si pengesë. Si pengesë mund të konsiderohet implementimi i tarifave për shfrytëzimin e sistemit të distribucionit për shkak të nivelit të lartë të humbjeve teknike dhe komerciale dhe të mungesës së matjeve multifunkionale për konsumatorët e vegjël.

6.2 Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë

Zhvillimi dhe reformimi i tregut ka për qëllim krijimin e mirëfilltë të konkurrencës në anën e furnizuesit ku konsumatorët të kenë mundësi të furnizohen nga furnizues të ndryshëm të energjisë elektrike.

Kosova ka bërë hapjen e tregut ku konsumatorët jo-familjar mund të ushtrojnë të drejtën e eligjibilitetit. Kërkesat e Traktatit për Komunitetin e Energjisë janë që duke filluar nga 1 Janar 2015 të gjithë konsumatorë duhet të kenë mundësinë të jenë të kualifikuar. Lidhur me këtë me poshtë mund të shihen edhe kërkesat nga ligjet e energjisë në Kosovë:

- **Ligji për energjinë elektrike, neni 19.4** - Të gjithë konsumatorët përveç konsumatorëve shtëpiak janë konsumator të kualifikuar. Të gjithë konsumatorët do të jenë konsumator të kualifikuar më 1 janar 2015.
- **Ligji për Rregullatorin e Energjisë, neni 41.1** - Zyra e Rregullatorit të Energjisë mund të vendosë tarifën të cilat u ngarkohen konsumatorëve të kualifikuar nga ndërmarrja e energjisë elektrike e cila është bartëse e licencës për furnizim publik vetëm kur Zyra nuk është e kënaqur me efektshmërinë e konkurrencës në furnizimin e energjisë elektrike.
- **Ligji për Rregullatorin e Energjisë, neni 41.2** - Pas 1 Janarit 2015 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të ndërpresë caktimin e tarifave të cilat u ngarkohen konsumatorëve nga ndërmarrja e energjisë elektrike që mban licencën për furnizim publik, përveç nëse Zyra nuk është e kënaqur me efektshmërinë e konkurrencës në furnizimin e energjisë elektrike.
- **Ligji për Rregullatorin e Energjisë, neni 41.3** - Çdo konstatim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë se konkurrenca në furnizimin e energjisë elektrike nuk është efektive duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të publikuar të kushteve të tregut. Rregullimi i tarifave nuk do të tejkalojë masën e nevojshëm për kompensimin e mungesës së konkurrencës efektive.

Interesimi i konsumatorëve jo-familjar ndaj hapjes së tregut të energjisë elektrike është i vogël. Interesi i kufizuar për tu nënshtruar eligjibilitetit shpjegohet me faktin se shumica e konsumatorëve do të përballen me çmime më të larta në tregun e hapur. Duke pasur parasysh tarifën aktuale të rregulluara, pak mund të pritet që të rritet interesimi i konsumatorëve për t'u furnizuar në tregun e hapur.

6.3 Konkurrenca nga këndvështrimi i furnizuesit

Problemet me të cilat ballafaqohet Furnizuesi Publik në kushtet e tregut të energjisë elektrike dhe shitjes së energjisë elektrike nuk janë të favorshme në rrethanë në të cilat bëhet shitblerja e energjisë elektrike për shkak të mungesës së prodhimit nga gjeneratorët vendorë.

Furnizuesi Publik tani për tani ka monopolin e shitblerjes së energjisë elektrike. Problemi tjetër paraqitet nga fakti se një pjesë e konsumatorëve të amvisërisë nuk i kryen obligimet që kanë ndaj Furnizuesit Publik.

7 Kriteret e vlerësimit të konkurrencës

Në Nenin 41 paragrafi 1.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (2010/03-L-185, shpallur më 25 tetor 2010) thuhet:

“Çdo konstatim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë se konkurrenca në furnizimin e energjisë elektrike nuk është efektive duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të publikuar të

kushteve të tregut. Rregullimi i tarifave nuk do të tejkalojë masën e nevojshëm për kompensimin e mungesës së konkurrencës efektive”.

Gjithashtu, në bazë të nenit 9 (1.1) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja obligohet të përfshijë brenda raportit të saj vjetor një përshkrim të zhvillimeve duke përfshirë në veçanti rezultatet e monitorimit nga ajo, të zhvillimit të konkurrencës në tregjet e energjisë në Kosovë. Neni 15 i të njëjtit ligj obligon ZRRE-në që të raportojë çdo vit për rezultatin e monitorimit të tregjeve të energjisë, duke përfshirë monitorimin e nivelit dhe efektivitetit të hapjes dhe konkurrencës së tregut në nivelet me shumicë dhe pakicë. Duke pasur parasysh këto detyrime, ZRRE vlerëson, për çdo vit, nëse ekziston konkurrencë efektive në furnizimin me energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar. Gjetjet e ZRRE-së përfshihen në raportin e saj vjetor.

Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur me 30 mars 2011 ka aprovuar kriteret për vlerësimin e konkurrencës në furnizim me energji elektrike.

Konkurrenca efektive në furnizimin me energji elektrike do të vlerësohet për tregjet në vijim:

- ✓ Shfrytëzuesit më të mëdhenj të energjisë: konsumatorët e kyçur në nivelin 110 kV e më lart (kategoria tarifore 01)
- ✓ Shfrytëzuesit energjisë në tensionin e mesëm: konsumatorët e kyçur në nivelet 35 kV dhe 10 kV (kategoritë tarifore 1 dhe 2)
- ✓ Shfrytëzuesit e energjisë në tensionin e ultë: konsumatorët e kyçur në nivelin 0.4 kV dhe të klasifikuar në kategorinë tarifore 3
- ✓ Shfrytëzuesit e vegjël të energjisë në tensionin e ultë: kategoritë tarifore 4 deri në 8.

ZRRE-ja në vlerësimin e saj për ekzistimin e konkurrencës efektive bazohet në atë se a ka dëshmi që furnizues konkurrent kanë qenë në gjendje të hyjnë në tregun relevant dhe të kenë sukses në tërheqjen e konsumatorëve nga Furnizuesi Publik. ZRRE-ja konsideron se, për arsye të qartësisë dhe transparencës, kriteret e përdorura në vlerësim duhet të jetë e mundshme që të definohen në terma objektiv, të qartë dhe lehtësisht të matshëm. Duke pasur parasysh këtë, ZRRE vlerëson që niveli i konkurrencës efektive në furnizim vlerësohet në bazë të dy kriterëve kryesore:

- *Numri i furnizuesve të pavarur aktiv në tregun relevant (përveç Furnizuesin publik) -* Kjo siguron një masë të intensitetit të konkurrencës. Për këtë arsye, ZRRE-ja ka vendosur që furnizuesi aktiv që konsiderohet për vlerësimin e kriterit të konkurrencës është ai që në vitin e kaluar ka furnizuar së paku 10% të tregut përkatës, matur sipas vëllimeve totale të konsumuara të energjisë.
- *Pjesa e tregut të shërbyer nga furnizuesit e pavarur.* - Kjo siguron një masë të efektivitetit të furnizuesve konkurrent në tërheqjen e konsumatorëve dhe për këtë arsye aftësinë e tyre për të siguruar një kontroll mbi fuqinë e tregut.

Gjithnjë sipas vendimit të ZRRE-së për kriteret e konkurrencës, tregu relevant konsiderohet konkurrent nëse i përmbush kushtet në vijim:

- Numri i furnizuesve në treg, duke mos përfshirë furnizuesin publik, duhet të jetë 3 apo më shumë; dhe

- Pjesa e tregut relevant të shërbyer nga furnizuesit, duke mos përfshirë furnizuesin publik, duhet të tejkalojë 30%.

8 Përfundimet në vlerësimin tre vjeçar të konkurrencës

Në bazë të kriterëve të paraqitura më lart, dhe duke vlerësuar gjendjen aktuale, ZRRE vlerëson se në Kosovë ende nuk ka konkurrencë efektive në furnizim me energji elektrike. Aktualisht të gjithë konsumatorët që kanë statusin e konsumatorit të kualifikuar furnizohen nga furnizuesi i vetëm publik me tarifa të rregulluara. Arsyeja e furnizimit të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të rregulluara është se në Kosovë përveç furnizuesit publik nuk operojnë furnizues të tjerë të pavarur.

Shkalla e konkurrencës në tregun me shumicë është e ulët, ku një gjenerator i vetëm shtetëror (TC Kosova A, B) dominon me afër 90% të tregut të brendshëm, ndërsa vetëm 10% plotësohet nga gjeneratorë të vegjël dhe importi, që tregon se në anën e gjenerimit nuk ka konkurrencë të mirëfilltë.

Furnizuesi Publik ka monopolin e shitblerjes së energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët, duke qenë se tërë energjia e prodhuar nga gjeneratorët i dedikohet Furnizuesit publik, dhe kjo është pengesë për të hyrë në treg furnizues të ri të pavarur. Me çmimin aktual të rregulluar, interesi i konsumatorëve të kualifikuar për të ushtruar të drejtën e tyre për të zgjedhur furnizuesin tjetër, është i kufizuar ose jo-ekzistues.

Në mënyrë që të krijohet një hapje e tregut, është e nevojshme të rritet gradualisht numri i konsumatorëve që furnizohen në tregun e hapur. Kjo mund të bëhet duke eliminuar tarifën e rregulluar për konsumatorët e kualifikuar, duke i ndryshuar rregullat e tarifave.

Qasja e palës së tretë në mënyrë transparente mundëson konkurrencë të mirëfilltë në një treg të energjisë.

KOSTT ka përgatitur një kornizë të mirë ligjore dhe teknike sa i përket qasjes së palës së tretë në sistemin e transmisionit dhe funksionet e Operatorit të Tregut, dhe mund të konkludohet se kjo mund të realizohet me sukses. Natyrisht kjo qasje i referohet tregut me shumicë, kurse realizimi i hapjes së tregut me pakicë i referohet plotësimin të kriterëve në sistemin e distribucionit. ku tash vone është aprovuar metodologjia për shfrytëzimin e sistemit të distribucionit, që për dallim nga vlerësimi i parë i tregut kjo çështje është konsideruar si pengesë . Po ashtu si pengesë mund të konsiderohet niveli i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale në distribucion dhe mungesa e matjeve multifunktionale për konsumatorët e vegjël.

Bazuar në ndryshimet që priten në ligjet primare, dhe në kërkesat që dalin nga direktivat Evropiane dhe Traktati i komunitetit të Energjisë, ZRRE do të veproj në drejtim të përshejtit të hapjes së tregut me shumicë dhe pakicë. Kjo fillimisht arrihet përmes vënies në dispozicion të një pjese të prodhimit në tregun e lirë, dhe pastaj me nxitjen e largimit të konsumatorëve (sidomos atyre më të mëdhenj) nga tarifën e rregulluar.